


INFORMACIÓN PÉR
PRINDÉR

Ethet



Ethet

Temperatura mesatare e trupit të një fëmije e matur sipas moshës është 37° Celsius. Temperatura e trupit nuk është kurrë konstante, ajo mundet sipas kohës së ditës të ndryshon deri 2 gradë Celsius (prej $36\text{--}38^{\circ}\text{C}$). Herët në mëngjes ajo është më e ulëta dhe herët në mbrëmje më e larta.

Për ethe bëhet fjalë, kur temperatura e trupit te foshnjat nën 3 muaj e tejkalon 38°C dhe te fëmijët më të vjetër e tejkalon $38,5^{\circ}\text{C}$.

Ekzistojnë shkaqe të ndryshme për ethe. Shkaku më i shpeshtë i eteve është moshën e fëmijërisë janë infekzionet, të cilat shkaktohen nga viruset. Infekzionet virale nuk mund të trajtohen me antibiotikë, pasi që këta nuk kanë asnjë ndikim ndaj tyre. Ndonjëherë ethet shkaktohen edhe nga infekzionet bakteriale.

Infekzionet me baktere munden të trajtohen saktësisht me antibiotikë. Në raste të rralla munden të shkaktojnë ethe edhe reaksionet alergjike, vaksinimet, sëmundjet kronike dhe shkaqe tjera të rralla.

Ethet nuk janë sëmundje, por është një shenjë e imunitetit mbrojtës të trupit. Ethet nuk janë të rrezikshme dhe lartësia e eteve nuk ka varësi me seriozitetin e sëmundjes aktuale.

Sa po të mundet infekzioni, menjëherë do të normalizohet temperatura e trupit.

Si të e matni temperaturën e fëmijës tuaj?

- Ne rekomojojmë te foshnjat nën 12 muaj, matjen e temperaturës në After.
- Te fëmijët mbi 1 vjeçar temperatura mund të matet nën sjetull, në gojë nën gjuhë apo edhe në vesh me termometër veshi. Nëse ju nuk keni matur ethet kurrë deri tani, pyetni te këshillimi i nënave, mjekun tuaj apo farmacistin për udhëzime.

Foshnjat nën 3 muaj, të cilat kanë temperaturë mbi 38°Celsius , duhet të paraqiten menjëherë para mjekut.

Ethet mund të ngritën ngadalë por edhe shumë shpejt. Në raste të rralla pranë një infekzioni me ethe mund të vjen edhe deri te ngërçet e eteve. Ngërçet e eteve janë të rralla, dhe shfaqen në mes të 6 muajve dhe 5 viteve dhe nuk kanë pasoja me kohëzgjatje të madhe për fëmijët (krahaso me fletushkën për prindër mbi ngërçet e eteve).

Kur do tē duhej tē shkoni te mjeku juaj?

Ethet e larta mund tē çojnë deri te ndikimi i gjendjes së përgjithshme tē fëmijës tuaj. Kur fëmija juaj nga ethet e larta është i ndikuar në gjendjen e tij tē përgjithshme (i zbutur, i lodhur, i irrituar, pinë pak):

- Zhvisheni fëmijën tuaj dhe visheni apo mbuloni lehtë
- Ethet e larta mund tē çojnë deri te humbja e lëngjeve, për këtë arsyje jepini shpesh sasi tē vogla lëngjesh si ujë apo çaj
- Jepini Paracetamol në formë të qirinjve apo sirup në sasi të llogaritur sipas moshës dhe sipas udhëzimeve tē paketimit çdo 6 orë në ditë maksimalisht
- Vrojtoni rrjedhën: Ethet do tē duheshin tē ulen dhe gjendja e përgjithshme e fëmijës tē përmirësohet. Nëse kjo nuk ndodh atëherë lajmëroni mjekun tuaj.
- Mos jepni Paracetamol më gjatë se 2 ditë çdo 6 orë pa e vizituar një mjek.

Petechiae



Nëse fëmija juaj i ka simptomat vijuese, ju do tē duhej tē shkoni te mjeku:

- Fëmija juaj është nën 3 muaj i ri dhe ka $\geq 38^{\circ}\text{Celsius}$ ethe
- Fëmija juaj ka dhimbje koke dhe qafë tē shtangular dhe i pengon drita
- Fëmija juaj vjell vazhdimisht dhe nuk pranon tē pinë
- Fëmija juaj ka zënie fryme
- Fëmija juaj bëhet gjithnjë e më tepër apatik, letargjik
- Fëmija nuk bëhet më mirë edhe përkundër dhënies së rregullt tē Paracetamolit
- Fëmija juaj ka më tepër se 2 ditë ethe dhe ju i jepni çdo 6 orë Paracetamol
- Fëmija juaj ka ngérçë ethesh
- Fëmija juaj ka puçrra në trup në formë tē pickimeve tē pleshtave, tē pa shtypshme, me pikë / njolla tē kuqe (krahaso fotografinë)

Stacioni i emergjencës Spitali i fëmijëve Zürich

Telefoni me pagesë për këshilla: 0900 266 71 1

Përbledhje:

- Fëmijët kanë shpesht ethe. Shkaqet më të shpeshta janë infektimet me viruse
- Foshnjat nën 3 muajsh me ethe $>38^{\circ}\text{Celsius}$ duhet menjëherë të paraqiten te mjeku
- Ethet nuk janë as të dëmshme e as të rrezikshme porse shenjë, që trupi po mbrohet ndaj infektit. Me rëndësi është vetëm e vetëm gjendja e fëmijës, e jo lartësie e etheve,
- Kur fëmija juaj është në një gjendje të përgjithshme të mire (ka dëshirë të luaj, duket i kënaqr) ju nuk duheni të i ulni gjithsesi ethet, pranë ndikimit në gjendjen e përgjithshme, te ethet ju mund të i jepni maksimalisht çdo 6 orë Paracetamol qirinj- apo në formë siripi, të pritni dhe të e vrojtoni rrjedhën
- Gjithsesi do të duhej të lajmëroheni te mjeku në rast të eteveve dhe simptomave të lartë përmendura apo kur ju ndiheni të pasigurt dhe jeni të merakosur për fëmijën tuaj